



*RAPORTI VJETOR*  
*ANNUAL REPORT*  
**2014**





Mendo nëse  
DËSHIRON të  
sigurohesh **1** ka  
vetëm **1** emër...

Mendo



# PËRMBLEDHJE


## Contents

|   |  |  |  |
|---|--|--|--|
|  |                         |   |                             |
| <h3>14</h3> <p>SIGAL UNIQA 15 vjet<br/>15 years of SIGAL UNIQA</p>                | <h3>15</h3> <p>Të parët në tregun e sigurimeve në KOSOVË<br/>The first in insurance market of Kosova</p> | <h3>16</h3> <p>Ndërtohet e para klinikë lëvizëse "SIGAL UNIQA"<br/>SIGAL UNIQA built the first portable health clinic "VitalTruck"</p> | <h3>17</h3> <p>SIGAL Prishtina triumfon në Ligën Ballkanike<br/>SIGAL Prishtina triumphs in Balkan Leagues</p> |

|   |    |
|---|----|
| Grup Rajonal Sigurimesh / Regional Insurance Group .....  | 05 |
| Fjala përshëndetëse / Forewards .....   | 06 |
| CEO i UNIQA Insurance Group / CEO of UNIQA Insurance Group  |    |
| CEO i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA / CEO of SIGAL UNIQA Group AUSTRIA  |    |
| Vlerat dhe Parimet / Our values and principles .....  | 12 |
| Aksionerët tanë / Our shareholders .....  | 13 |
| Ngjarje të rëndësishme / Important events .....   | 14 |
| SIGAL UNIQA 15 Vjet / 15 years of SIGAL UNIQA   |    |
| "SeeNews" vlerëson SIGAL UNIQA si një ndër kompanitë më të mira në rajon! / "SeeNews" estimates SIGAL UNIQA as one of the best companies in the region! |    |
| Të parët në tregun e sigurimeve në KOSOVË / The first in insurance market of Kosova   |    |
| Ndërtohet e para klinikë lëvizëse "SIGAL UNIQA" / SIGAL UNIQA built the first portable health clinic "VitalTruck"                                       |    |
| SIGAL Prishtina triumfon në Ligën Ballkanike / SIGAL Prishtina triumphs in Balkan Leagues   |    |
| SIGAL UNIQA promovon turizmin në Shqipëri / SIGAL UNIQA promotes Albanian Tourism   |    |
| Përgjegjësia jonë sociale / Our Social Responsibility .....   | 19 |
| Skuadra SIGAL UNIQA / SIGAL UNIQA Team.....   | 22 |
| Fushata e re "Mendo" / New Advertisement Campaign "Think" .....   | 23 |
| Të dhëna financiare / Financial data .....  | 25 |
| Tregu rajonal i sigurimeve / Regional Insurance Market .....  | 26 |
| Raporti i auditit / Audit Report .....  | 30 |

# GRUP RAJONAL SIGURIMESH

## Regional Insurance Group



### Volumi i primeve (Euro)

Premium volum

|              |                   |
|--------------|-------------------|
| <b>Group</b> | <b>51,195,794</b> |
| AL           | 27,489,743        |
| KS           | 12,729,543        |
| MK           | 10,976,508        |

### Nr. i kontratave

Nr. of contracts

|              |                |
|--------------|----------------|
| <b>Group</b> | <b>674,286</b> |
| AL           | 236,214        |
| KS           | 113,565        |
| MK           | 324,507        |

### Nr. i zyrave

Nr. of offices

|              |            |
|--------------|------------|
| <b>Group</b> | <b>210</b> |
| AL           | 109        |
| KS           | 59         |
| MK           | 42         |

### Agjentë dhe punonjës

Agents and employees

|              |             |
|--------------|-------------|
| <b>Group</b> | <b>1036</b> |
| AL           | 602         |
| KS           | 107         |
| MK           | 327         |



Andreas Brandstetter  
CEO, UNIQA Insurance Group  
Kryetar, Bordi Mbikëqyrës i SIGAL UNIQA

### *Të dashur aksionerë,*

2014-ta ishte viti i tretë i programit tonë afatgjatë "UNIQA 2.0", të cilin e prezantuam përpara jush në mes të vitit 2011. Kemi përmbushur një marrëveshje të madhe këto 12 muajtë e fundit në një mjedis sfidues, edhe pse jo çdo gjë që kishim planifikuar është realizuar.

Jemi duke ecur me hapa të plotë për të plotësuar objektivat tonë dhe do të vazhdojmë të ndjekim hap pas hapi zhvillimin e UNIQA's, për të arritur qëllimin afatgjatë për t'u shndërruar në liderin e sigurimeve në Europën Qendrore dhe Lindore.

Në 19 vende të Europës, në të cilët jemi aktivë, kemi fituar besimin e më shumë se 10 milionë klientëve, të cilëve ju detyrohem një falënderim për 6.1 miliardë Euro prime. Ndaj, unë dua sinqerisht të falënderoj të gjithë klientët, gjithashtu edhe rreth 22 mijë punonjësit dhe partnerët tanë të biznesit.

Qëllimet operative për 2015 janë të qarta: Ruajtja e rentabilitetit të mirë në sigurimin jetës dhe të shëndetit dhe në veçanti një përmirësim i pastër në sigurimin e pronës dhe pasurisë. Kjo është edhe më e rëndësishme përse i përket të ardhurave neto në terma afatmesëm, të cilat në vitin 2014 rezultuan të jenë shumë pozitive me një kthim prej 3.8%, në një fazë të rindërtimit të ndarjes së aseteve tona nuk mund të mbahet në këtë nivel.

Pas viteve të përgatitjeve intensive brenda kompanisë

tonë, ne jemi të kënaqur që në mbarë Evropën kuadri rregullator Solvency II hyn në fuqi duke filluar nga 1 janari 2016, i cili do të sjellë një fokus të fuqishëm në qasjen afatgjatë e të zellshme ekonomike për menaxhimin e ndërmarrjeve të sigurimeve.

Në emër të Bordit Drejtues, do të doja të shprehja mirënjohjen tonë të sinqertë partnerëve tanë për interesin ndaj UNIQA's. Ne do të vazhdojmë të punojmë vazhdimisht për të përmbushur pritshmëritë tuaja.

**Andreas Brandstetter**  
CEO, UNIQA Insurance Group  
Kryetar, Bordi Mbikëqyrës i SIGAL UNIQA GROUP  
AUSTRIA

“  
Në 19 vende të Europës, në të cilët jemi aktivë, kemi fituar besimin e më shumë se 10 milionë klientëve, të cilëve ju detyrohem një falënderim për 6.1 miliardë Euro prime.”



Avni Ponari  
CEO, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA  
Anëtar, Bordi Mbikëqyrës i SIGAL UNIQA

*Të dashur miq,  
klientë dhe partnerë të SIGAL UNIQA  
GROUP AUSTRIA,*

Viti 2014 ishte një vit suksesi dhe arritjesh për të gjithë ne, për SIGAL UNIQA, partnerët e saj, punonjësit e mbi të gjitha për Ju klientë që na besuat sigurimin e jetës, shëndetin, pasurinë dhe çdo aset tjetër me vlerë. Falë strategjisë së ndërtuar dhe punës së palodhur të mbi 1100 punonjësve dhe agjentëve, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA u rendit sërish në krye të tregut të sigurimeve edhe për vitin 2014. Në krahasim me një vit më parë, ne u rritëm me 16.04%, duke arritur një volum primesh prej 3076 milionë Lekësh.

Përgjatë 12 muajve të kaluar ne kemi ecur me hapa të sigurtë drejt përbushjes së objektivave tona afatgjata dhe qëllimit tonë kryesor për të qenë lider të tregut të sigurimeve në rajon. Aktualisht renditemi si një prej grupeve më të mëdhenj rajonale të sigurimeve, duke zotëruar rreth 16% të tregut të sigurimeve në rajon, ndërsa në Shqipëri dhe Kosovë renditemi të parët në treg.

Që nga viti i themelimit, 1999, e deri më sot kemi fituar besimin e mbi 1 milionë klientëve në rajon nëpërmjet 8 kompanive sigurimi jetë, jo-jetë, risigurime dhe pensione private. Një ndër treguesit dhe faktorët kyç të besueshmërisë që gëzojmë është pagesa në kohë e dëmeve ndaj klientëve tanë. Që prej themelimit e deri vjet SIGAL UNIQA ka paguar mbi 90 milionë euro dëme, që zënë mbi 45% të pagesës totale të dëmeve në tregun e sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

Viti 2014 shënoi edhe 15-vjetorin e SIGAL UNIQA, përvjetori i një rrugëtimi të mbushur me lodhje, sakrificë por edhe emocione e suksese të një-pas-njëshme. Në vitin 1999 e filluam punën me një staf prej vetëm 22 punonjësish dhe një kapital 400 mijë dollarë. Sot, SIGAL UNIQA GROUP

AUSTRIA numëron mbi 1100 punonjës dhe agjentë të kualifikuar për të gjitha klasat e sigurimit dhe kapital mbi 51 milionë Euro. Këto shifra janë treguesë të suksesit që kemi patur ndër vite, sukses për të cilin unë jam i bindur që do të vazhdojë së bashku me punën profesionale të punonjësve, mbështetjen e bashkëpunëtorëve tanë e mbi të gjitha me besimin e klientëve tanë.

Ky vit shënoi edhe një tjetër përvjetor, plot 7 vite bashkëpunim të frytshëm me UNIQA Insurance Group Austria, një nga grupet më të fuqishme financiare në Europë, me një eksperiencë mbi 150-vjeçare në tregun e sigurimeve, e vlerësuar vazhdimisht me "A" nga Standart & Poor's. Asetet e UNIQA llogariten në mbi 26 miliardë Euro, numëron rreth 22 000 punonjës dhe rreth 8 milionë kontrata në 19 shtetet europiane, ku operon me 40 kompani. Investimi i UNIQA Insurance Group në Shqipëri është një garanci jo vetëm për SIGAL, por për të gjithë tregun shqiptar dhe atë rajonal të sigurimeve. SIGAL UNIQA ishte e para kompani që tërhoqi të parin investitor të huaj në Shqipëri, Fondin Shqiptaro-Amerikan, me të cilin mbushëm plot 11 vjet bashkëpunim të frytshëm.

Gjatë këtyre 15 viteve kemi treguar se jemi gjithmonë një hap përpara, shohim mundësi të reja aty ku të tjerët nuk i shohin, pasi ndjekim në çdo moment kërkesat e tregut dhe nevojat e klientëve, me synimin për tu qëndruar atyre gjithmonë pranë. Përmes hartimit dhe ofrimit të produkteve novatore, përkujdesjes maksimale ndaj klientëve dhe pagesës në kohë të dëmeve, qëllimi ynë është që t'i bëjmë ata të ndjehen të qetë dhe të sigurtë. Çdo arritje dhe sukses është meritë e Juaja!

Miqësisht,  
**Avni PONARI**  
**Drejtore i Përgjithshëm, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA**  
**Anëtar, Bordi i Mbikëqyrjes SIGAL UNIQA**

“  
*Gjatë këtyre  
15 viteve kemi  
treguar se jemi  
gjithmonë një hap  
përpara, shohim  
mundësi të reja  
aty ku të tjerët  
nuk i shohin,  
pasi ndjekim  
në çdo moment  
kërkesat e tregut  
dhe nevojat e  
klientëve, me  
synimin për tu  
qëndruar atyre  
gjithmonë pranë!*  
”

Mendo rëndësinë  
e një PARTNERI  
të SUKSESSHËM!



## VLERAT DHE PARIMET TONA



### Cilësia

Ofrimi i një shërbimi cilësor që të përmbushë nevojat e klientëve është fjala kyçe e aktivitetit tonë. Jemi kompania më e madhe dhe më e besueshme e sigurimeve për shqiptarët, të cilët kanë vlerësuar maksimalisht cilësinë tonë të shërbimit.

### Respekti

Respekti për nevojat, mirëqenien dhe opinionin e klientëve, punonjësve dhe partnerëve tanë janë në qendër të vendimeve që marrim çdo ditë. Ne tregojmë respekt në çdo hap që hedhim, duke filluar nga dizejnimi i produkteve, strukturave dhe proceseve e deri tek ofrimi final i shërbimit ndaj klientëve.

### Mirësjellja

Ne besojmë se komunikimi është çelësi i suksesit për çdo kompani, ndaj sjellja profesionale dhe korrekte si brenda kompanisë ashtu edhe me partnerët dhe klientët është shumë e rëndësishme për ne. Ne i mbajmë dhe i zhvillojmë marrëdhëniet mbi bazën e besimit, ndaj fokusohemi në gjetjen e zgjidhjeve të duhura.

### Harmonia

Ne i kushtojmë shumë rëndësi bashkëveprimit mes të gjithë aktorëve në punën tonë: klientëve, autoriteteve mbikqyrëse, aksionerëve dhe stafit. Organizimi që kemi është në funksion të një komunikimi të mirë së brendshmi dhe njëkohësisht në përputhje me kërkesat dhe dinamizmin e një tregu që zhvillohet dita-ditës.

### Zhdërvjelltësia

Në punën tonë të përditshme nxitemi nga dëshira për tu ofruar vlera dhe shërbim cilësor klientëve tanë dhe një mjedis pune të kënaqshëm stafit tonë. Bazuar në këto parime, jemi vazhdimisht të vëmendshëm ndaj mendimit të klientëve, ndaj përshtasim shërbimin tonë me nevojat e tyre.

## AKSIONERËT TANË

### UNIQA Insurance Group


UNIQA Insurance Group është aksioneri më i madh i SIGAL UNIQA, që nga muaji mars i vitit 2007 dhe zotëron 68.64% të aksioneve. UNIQA Insurance Group është një nga grupet më të fuqishme financiare në Europën Qendrore dhe Lindore, nën emrin e së cilës përfshihen 40 kompani sigurimi që operojnë në 20 shtete. E vlerësuar vazhdimisht nga 'Standard&Poor's' me "A", UNIQA është një gjigand europian sigurimesh.

### Fondi Amerikan

Fondi Amerikan zotëron 13.3% të aksioneve të SIGAL dhe është aksioneri ynë që nga tetori i vitit 2003. Fondi Amerikan është themeluar me iniciativë dhe vendim të Kongresit Amerikan në vitin 1995, në kuadër të marrëveshjes "Për Demokracinë e Europës Lindore". Qëllimi kryesor i Fondit është të promovojë zhvillimin e ekonomisë në vendet me ekonomi të brishtë.

### Investitorë vendas

18.06% e aksioneve të SIGAL UNIQA i përkasin investitorëve shqiptarë, njëkohësisht themeluesë të kompanisë.



## NGJARJE TË RËNDËSISHME



Moment nga festimet e 15-vjetorit të SIGAL UNIQA Group Austria.

(Nga e majta)

Z. Avni Ponari, CEO i SIGAL UNIQA Group Austria  
Z. Niko Peleshi, Zv. Kryeministër i Republikës së Shqipërisë  
Z. Ilir Meta, Kryetar i Parlamentit të Republikës së Shqipërisë  
Z. Andreas Brandstetter, CEO i UNIQA Insurance Group  
Z. Erhard Busek, Anëtar i Bordit Mbikqyrës i SIGAL UNIQA  
Z. Wolfgang Kindl, CEO i UNIQA International  
Z. Martin Mata, Co-CEO i Fondit Amerikan

### SIGAL UNIQA 15 vjet

Viti 2014 ishte një vit i veçantë për kompaninë "SIGAL UNIQA Group AUSTRIA", pasi 2014-ta shënoi 15-vjetorin e lindjes së saj. Plot 15 vjet nga themelimi, SIGAL UNIQA shënon një histori sukse si në tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, ku zë rreth 16% të tregut të rajonit dhe është lider në tregun shqiptar që prej vitit 2002, me mbi 35% të të gjithë tregut.

Me rastin e 15-vjetorit, kompania më e madhe e sigurimeve në vend, organizoi një mbrëmje gala në Teatrin e Operas dhe Baletit, ku morën pjesë përfaqësues të lartë të politikës shqiptare, si: Zëvendëskryeministri Niko Peleshi, kryeparlamentari Ilir Meta, ministra të kabinetit qeveritar, ambasadorë, përfaqësues të financave, bizneseve, artit, kulturës e medias.

Z. Peleshi shprehu mirënjohjen për punën që SIGAL dhe UNIQA kanë bërë përgjatë këtyre viteve për zhvillimin e tregut dhe ekonomisë shqiptare, si dhe garanto mbështetjen e qeverisë shqiptare për zhvillimin e tregut të sigurimeve. Bordi Mbikqyrës i SIGAL UNIQA dha në të njëjtën ditë një konferencë për mediat, duke iu përgjigjur interesit të gazetarëve mbi performancën e SIGAL UNIQA përgjatë 15 viteve, zhvillimet të tregut në Shqipëri dhe planet e UNIQA Insurance Group për Shqipërinë. Në fjalën e tij, Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, z. Avni Ponari foli për arritjet e kompanisë përgjatë këtyre viteve dhe sfidat aktuale të tregut.

Z. Andreas Brandstetter, CEO i UNIQA, foli për potencialin e madh që ka tregu shqiptar i sigurimeve, për zhvillimin e mëtejshëm të tij e veçanërisht përse i përket sigurimeve të jetës dhe shëndetit.

Dr. Erhard Busek, Ish-Koordinator i Paktit të Stabilitetit dhe Anëtar i Bordit Mbikqyrës të SIGAL UNIQA, u shpreh se sukse si i SIGAL UNIQA është jo thjesht një histori sukse si



Balerini Eno Peçi, solist i Teatrit Vjenez të Operas dhe Baletit, në mbrëmjen artistike me rastin e 15-vjetorit të SIGAL UNIQA.

në Shqipëri, por një shenjë e mirë e zhvillimit të të gjithë rajonit.

### "SeeNews" vlerëson SIGAL UNIQA si një ndër kompanitë më të mira në rajon!

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA për të disatin vit radhazi, edhe në vitin 2014, u rendit ndër 100 kompanitë më të mira të vendeve të Europës Jug-Lindore. "SeeNews.com", ofruer i të dhënave të biznesit dhe inteligjencës për Europën Jug-Lindore, në listën e publikuar për 100 kompanitë më të mira të rajonit për vitin 2014, e renditi kompaninë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA një ndër 100 kompanitë më të mëdha e më të sukse shme të tregut rajonal.

Falë punës dhe përkushtimit të stafit dhe partnerëve, falë menaxhimit të shkëlqyer të drejtuesve të kompanisë, e mbi të gjitha falë besimit të mbi 1 milionë klintëve në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni, SIGAL UNIQA është krenare që renditet në 100 kompanitë më të mira të rajonit, si e vetmja kompani sigurimesh e rankuar në këtë listë. Jemi më të mirët dhe kjo falë Jush! Faleminderit që na besoni!

### Të parët në tregun e sigurimeve në KOSOVË

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA vazhdon të ruajë pozicionin e saj lider në tregun e sigurimeve në Kosovë. Përgjatë vitit 2014 SIGAL UNIQA Jo-Jetë KOSOVË zotëroi 24.22% të tregut, duke shënuar kështu një rritje prej rreth 9% nga viti 2013. Hapat e sigurtë në të cilat po ecën kompania SIGAL UNIQA në Kosovë, bën që edhe në vitin e saj të 11-të të ushtrimit të aktivitetit, treguesit të jenë pozitivë dhe gjithmonë në rritje. Edhe SIGAL Life-Kosova mbajti një pozicion të mirë në treg, edhe pse ka pak vite që operon e pavarësisht numrit të lartë të kompanive që operojnë në tregun e sigurimeve. Ajo u rendit si një nga tri kompanitë më të mira dhe treguesit



Tenori Josif Gjipali i shoqëruar nga orkestra rajonale e Klubit të Artit dhe Kulturës të SIGAL UNIQA, nën dirigjimin e Mjeshtër të Madh Ermir Dizdari.



Bordi Mbikqyrës i SIGAL UNIQA në zyrat e SIGAL UNIQA Prishinë. (Nga e majta)  
Z. Avni Ponari, CEO i SIGAL UNIQA Group Austria  
Z. Andreas Brandstetter, CEO i UNIQA Insurance Group  
Z. Wolfgang Kindl, CEO i UNIQA International





Klinika lëvizëse SIGAL UNIQA Group Austria.

financiarë janë gjithmonë në përmirësim.

Tregu i sigurimeve në Kosovë ka një potencial të lartë të pashfrytëzuar, çfarë na bën optimistë për qëndrueshmërinë e kompanisë si dhe për mundësitë e mëdha që ka SIGAL UNIQA për t'u zhvilluar e rritur më tej. Objektivat tanë janë afatgjatë, ndaj dhe jemi në rrugën e duhur për t'i realizuar.

#### Ndërtohet e para klinikë lëvizëse "SIGAL UNIQA"

Kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA përgjatë vitit 2014 erdhi pranë banorëve me një risi të re: Klinikë lëvizëse "SIGAL UNIQA".

E para dhe e vetmja e këtij lloji në Shqipëri dhe rajon, klinika lëvizëse është ideuar me qëllim për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve të Shqipërisë edhe më gjerë, nëpërmjet ofrimit të ekzaminimeve shëndetësore falas. Klinika do ta fillojë punën e saj në Shqipëri, ku do të shkojë në çdo qytet të Shqipërisë por edhe në zonat malore, aty ku banorët e kanë të pamundur që të kryejnë ekzaminime shëndetësore për shkaqe ekonomike dhe infrastrukturore. Destinacionet e radhës do të jenë Kosova dhe Maqedonia, si pjesë e pandashme e klientëve të SIGAL UNIQA dhe jo vetëm. Shërbimet shëndetësore do t'u ofrohen të gjithë qytetarëve, pa dallim!

Me një staf mjekësor profesional, në klinikën lëvizëse SIGAL UNIQA, mundësohen një shumëllojshmëri ekzaminimesh, duke filluar nga vizitat dhe konsultat me mjekun patolog, matjet e sheqerit në gjak, vizitë sysh e ORL deri tek imazheritë të tilla si: Elektrokardiograma e zemrës, Echo abdominale, Echo e indeve të buta, Echo e artikulacioneve, matje e kapacitetit vital të mushkërive, matje e oksigjenit në gjak me spirometër etj.

Duke mundësuar ekzaminime të ndryshme mjekësore në të gjithë vendin, përfshirë zonat rurale, SIGAL UNIQA synon promovimin e shëndetit të mirë, duke nxitur qytetarët për kontrolle shëndetësore rutinë, në mënyrë që



Gjatë turit të klinikës lëvizëse SIGAL UNIQA Group Austria në Shqipëri.

të diagnostikohen sëmundjet në kohë dhe të parandalohen. Është shumë më mirë ta parandalosh një sëmundje sesa ta kurosh atë!

#### SIGAL Prishtina triumfon në Ligën Ballkanike

SIGAL Prishtina, e mbështetur nga SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, ka pasur një vit të suksesshëm për vitin e kaluar. Ajo ka triumfuar në Ligën Ballkanike, duke u shpallur kampione me meritë të plotë ndaj ekipit bullgar. Bardhë e Blutë e Prishtinës kanë patur një periudhë të artë dhe janë gjithmonë në ngjitje përsa i përket cilësisë dhe rezultateve.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA është krenare që mbështet dhe është sponsor zyrtar i një skuadre të shkëlqyer dhe me djem të talentuar. Ne do të vazhdojmë të mbështesim SIGAL Prishtinën dhe të festojmë së bashku fitore të tjera të kësaj skuadre të madhe. Mendo, me SIGAL UNIQA jeni gjithmonë kampionë!

#### SIGAL UNIQA promovon turizmin në Shqipëri.

Ndër të shumtat aktivitete për promovimin e Shqipërisë, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, përgjatë vitit 2014 organizoi një guidë turistike 1-ditore në skajin verior të vendit, në Valbonë. Udhëtimi u realizua falë nismës së Drejtorit të Përgjithshëm të SIGAL UNIQA, z. Avni Ponari, me qëllim promovimin e turizmit malor dhe njohjen e traditave tona të pasura. Rreth 150 përfaqësues të institucioneve kryesore financiare, si banka, kompani sigurimesh dhe biznese të ndryshme ishin mysafirë të banorëve të Valbonës, të cilët përveç prodhimit të ushqimeve bio, natyrës së mrekullueshme që iu ka falur Zoti, shquhen edhe për bujarinë dhe mikpritjen. Kjo iniciativë u mbështet edhe nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të asaj kohe, z. Erion Veliaj, i cili iu bashkua me shumë kënaqësi guidës, duke e konsideruar atë si një promovim shumë të mirë të Shqipërisë.



Gjatë një ndeshjeje të skuadrës kosovare SIGAL Prishtina.



Udhëtim me traget në Valbonë, organizuar nga SIGAL UNIQA.

Mendo kompaninë nr.1  
në tregun KOSOVAR të sigurimeve!



## PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Si kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri, në 15 vitet e aktivitetit tonë, kemi synuar që krahas punës së përditshme të kontribuojmë vazhdimisht për aktivitetet kulturore, artistike, sportive dhe sociale në Shqipëri.

### Arti dhe Kultura

Që nga viti i themelimit, Klubi i Artit dhe Kulturës është shndërruar në vatrën e artistëve dhe dashamirësve të kulturës. Vetëm gjatë vitit 2014 janë zhvilluar mbi 50 aktivitete të ndryshme, përfshirë koncerte recitale, aktivitete për të rinj, promovime librash, evente muzikore, ekspozita me piktura dhe fotografi etj. Në këtë mënyrë Klubi i Artit dhe Kulturës e ka përmbushur mjaft mirë qëllimin e themelimit të tij dhe ka kontribuar në promovimin e artit dhe kulturës shqiptare. Kemi synuar që të mbështesim artistët në punën e tyre e mbi të gjitha të edukojmë publikun që ta duan dhe promovojnë artin shqiptar, si një pasuri kombëtare e padyshim si një panoramë e shkëlqyer e vendit tonë.

Në kuadër të mbështetjes së artit, me kënaqësi ishim prezentë si mbështetës të Natës Vjeneze-mbrëmjes artistike me solistin e Teatrit Vjenez të Operas dhe Baletit Eno Peçi. Festivali "Different Trains" është një tjetër event artistik i mbështetur prej nesh prej disa vitesh. Artistë shqiptarë dhe të huaj, për disa netë më radhë luajtën përpara publikut shqiptar pjesë muzikore të artistëve me famë botërore. Mikpritja që u bëri publiku shqiptar dhe duartrokitjet që u dhanë artistëve na bënë të ndjehemi krenarë që i kemi mbështetur dhe padyshim do të vazhdojmë të jemi përkrah tyre edhe në vitet e ardhshme.

"Festivali i Librit dhe i Artit", "Festivali Ndërkombëtar i Vokalit Operistik Marije Kraja", "Gran Gala Operistike me Yjet e Operas Shqiptare", "Kënga Magjike 2014", "Çmimet Kult 2014", "Ekspozita Fotografike - Eksplorimi i një Peisazhi", janë të tjera evente që SIGAL UNIQA Group AUSTRIA ka mbështetur përgjatë vitit 2014.



Nata Vjeneze, balerini Eno Peçi





### Arsimi

Me bindjen se investimi tek arsimimi dhe edukimi i brezit të ri është garancia më e mirë për të ardhmen, mbështesim vazhdimisht institucione të ndryshme arsimore, si përmes bursave të studimit (Shkolla Austriake në Shkodër, mjete mësimore në shkollën 9-vjeçare në Vermosh) ashtu dhe nëpërmjet praktikave mësimore të realizuara pranë SIGAL UNIQA dhe mbështetjen e saj, për studentë të universitete të ndryshme në vend.

### Sporti

Që prej fillimit të aktivitetit i kemi kushtuar vëmendje aktiviteteve sportive si basketbollit, futbollit, alpinizmit etj. Jemi mbështetës zyrtarë të Federatës Shqiptare të Basketbollit, përmes së cilës kemi iniciuar projekte dhe aktivitete për përfshirjen e të rinjve në sport. Jemi krenarë që skuadra kampione e basketbollit kosovar mban emrin tonë: "SIGAL Prishtina". Klubi i Basketbollit Vllaznia gjithashtu ka pasur mbështetjen financiare të SIGAL UNIQA. Për të disatin vit radhazi mbështesim aktivitetin sportiv "Streetball Albania", së bashku me Federatën Shqiptare të Basketbollit dhe bashkitë e qyteteve, ku me dhjetëra të rinj iu bashkuan iniciativës për të dalë në rrugët e qytetit të tyre për të luajtur basketball.

### Sociale

Kemi treguar që jemi humanë dhe që i kushtojmë vëmendje projekteve sociale në të mirë të komunitetit. Përgjatë vitit 2014 kemi mbështetur një sërë aktivitesh dhe projektesh, ndër të cilët: Ndërtimi i kullave të vrotimit në dy plazhe në zonën e Durrësit; Mbështetje për vënie në dispozicion për përdorim të 60 biçikletave për sezonin turistik veror 2014; Mbështetje për dhuratat e fundvitit për Spitalin Pediatrik në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza, etj.



SIGAL Prishtina, skuadra kampione e basketbollit në Kosovë.



Kulla e vrotimit, Durrës.

# Mendo besimin e MIJËRA klientëve në MAQEDONI!



## SKUADRA SIGAL UNIQA

### PUNONJËSIT DHE PARTNERËT

Suksesi ynë janë punonjësit dhe partnerët tanë. Të gjithë ecurinë dhe suksesin e arritur përgjatë këtyre viteve në tregun e sigurimeve, padyshim që u'a dedikojmë punonjësve tanë. Ne jemi SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA dhe të gjithë së bashku punojmë për të mirën e klientëve tanë!

Mbi 1100 punonjës dhe agjentë shitjesh të SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni punojnë me përkushtim si një grup kompakt për të arritur objektivat. Përkushtimi i tyre është faktori kyç i suksesit të kompanisë. SIGAL UNIQA promovon zhvillimin profesional të punonjësve të saj dhe u ofron atyre kushtet më të mira në ambientet e punës.

### SKUADRA SIGAL UNIQA

1187 punonjësit dhe agjentët e SIGAL UNIQA punojnë për një qëllim të përbashkët: Tu shërbejnë klientëve, duke u ofruar atyre siguri për ta bërë jetën e tyre dhe të familjeve të tyre më të thjeshtë. Punonjësit tanë fokusohen tek nevojat e klientëve, duke implementuar një standard të lartë në shërbimin që ofrojmë çdo ditë. SIGAL UNIQA respekton barazinë gjinore edhe tek punonjësit, ku rreth 52% e punonjësve janë meshkuj dhe 48% femra. Pjesa më e madhe e të punësuarëve tek SIGAL UNIQA kanë një mesatare prej 6 vitesh punë, duke dëshmuar kështu qëndrueshmërinë e burimeve njerëzore dhe investimin tek stafi, në periudha kohore afatgjata.

### DREJT EKSELENCËS

Ne investojmë tek punonjësit tanë që ata të jenë më të mirët. Stafi i SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni trajnohen çdo vit nga partnerët tanë në Austri, duke përvetësuar njohuritë më të fundit nga

pikëpamja profesionale. Përkëtë arsye, punonjësit trajnohen periodikisht pranë institucioneve të rëndësishme financiare në Europë, së bashku me qindra menaxherë të kompanive të tjera të UNIQA Insurance Group.

Në mbështetje të programeve për rritjen profesionale, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA ka mbështetur financiarisht përfshirjen në programe specializimi pasuniversitar të punonjësve të saj në universitetet publike në Shqipëri dhe rajon.

### JETË SOCIALE DHE E SHËNDETSHME

Ne promovojmë një jetë sociale dhe të shëndetshme. SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA u ofron të gjithë punonjësve të saj një sërë mundësish për të qenë aktivë dhe të shëndetshëm. Klubi i Shëndetit "SIGAL VitalClub" ofron shërbime fizioterapie dhe fitness falas. Gjithashtu "Klinika SIGAL" ofron trajtime mjekësore falas për të gjithë stafin. Nuk mungojnë as aktivitetet sportive, si kampionati i Futbollit, Volejbollit apo sporte në ujë. SIGAL UNIQA organizon fundjava të ndryshme pranë "Vilës SIGAL" në Dardhë, ku mund të bëhet ski dhe stafi të socializohet më tepër me njëri-tjetrin.

### NE JEMI HUMANË

Të qenit human është motoja jonë. Secili nga ne mund të ndihmojë një familje në nevojë, duke i dhuruar një ditë të punës së tij/saj. Ne e inkurajojmë stafin tonë që ti kthejë diçka mbrapsh shoqërisë dhe të ndihmojë njerëzit në nevojë. Stafi i SIGAL UNIQA GROUP në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni ka vendosur ti bashkohet nismës së partnerëve tanë më të mëdhenj në Austri, me sloganin "Dita e Unikës për Përgjegjësinë Shoqërore", ku secili punonjës dhuron një ditë të punës së tij për të ndihmuar institucionet humanitare dhe familjet në nevojë.

## Fushata e re "Mendo"

Mesazhi 'Mendo të guxosh për lumturinë tënde'

Që prej dhjetorit 2014, SIGAL UNIQA ka implementuar një fushatë të re publicitare, mesazhi kryesor i së cilës është 'Mendo'. Në dallim nga fushatat dhe sloganet e mëparshme, fushata 'Mendo' paraqet një filozofi të re, një mënyrë të jetuari dhe menduari të orientuar nga pozitiviteti dhe lumturia. 'Mendo SIGAL UNIQA' nuk është një taktikë shitjeje sesa një qëndrim. 'Mendo' përcjell idenë e të qenit bashkë si një familje, është një këndvështrim aktiv dhe aspak pasiv apo negativ. Përmes fushatës së re, ne duam të inkurajojmë njerëzit që të ndërtojnë jetën e tyre, të minimizojnë frikën, të përballojnë problemet dhe të gjejnë lumturinë në jetë. Gjithashtu, duam ti nxitim ata që të marrin përsipër rreziqe të vogla, të kapërcejnë kufijtë personalë, të përqafojnë një perspektivë të re, të jenë optimistë. Përmes të gjitha këtyre, secili prej nesh do të ketë më shumë lumturi në jetë, duke guxuar më shumë për të.

Mesazhi 'Mendo SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA'

Slogani 'Mendo SIGAL UNIQA' i ndihmon klientët të mendojnë e të veprojnë ndryshe, si dhe ti shohin situatat në një këndvështrim të ri. SIGAL UNIQA dëshiron që t'u përcjellë këtë ide jo vetëm klientëve të saj por të gjithë audiencës. Duke pasur parasysh se shpesh njerëzit përballen krejt të vetëm me frikën dhe pasiguritë e tyre, ndaj SIGAL UNIQA dëshiron që përmes këtij slogani të ri të pozicionohet si një kompani që ofron besim dhe siguri, jo vetëm përmes produkteve të sigurimit, por mbi të gjitha si një partner afatgjatë dhe shoqëruar për një jetë më të mirë.

Me këtë synim, në strategjinë tonë të komunikimit kemi përfshirë krahas shprehjeve si 'Mendo e ardhmja të përket ty', 'Mendo ndonjëherë fiton, ndonjëherë mëson', 'Mendo familja është vendi më i sigurtë në botë', 'Mendo çfarë të bën të lumtur?', 'Mendo një ditë e re është një mundësi e re' dhe shumë shprehje e pyetje të tjera, të cilat i përdorim shpesh në komunikimin tonë të përditshëm dhe si të tilla janë pjesë e shprehive tona në familje, punë apo mes miqsh. Në këtë mënyrë, 'Mendo' po bëhet gradualisht pjesë e bisedave të çdokujt.

Ndonëse pak muaj pas lançimit, fushata 'Mendo' ka pasur një ndikim pozitiv tek audienca, duke e cilësuar atë si një risi në komunikimin e korporatave të mëdha në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni.




Mendo jo vetëm  
qirinjtë dhe fishekzjarret  
shkëlqejnë për Krishtlindje  
dhe Vitin e Ri!

**SIGAL**  
UNIQA GROUP AUSTRIA

Mendo  
nëse dëshiro  
të SIGURIMES  
kë...  
I emër...  
SIGAL UNIQA  
Group Austria

## TË DHËNA FINANCIARE

Grupi SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA  
Prime të shkruara për tre vitet e fundit




| Kompania                              | 2011<br>(në Euro) | 2012<br>(në Euro) | 2013<br>(në Euro) | 2014<br>(në Euro) |
|---------------------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| SIGAL UNIQA AL Jo-Jetë dhe Risigurime | 17,133,284        | 17,598,129        | 18,920,508        | 21,976,027        |
| SIGAL Life UNIQA AL                   | 3,645,281         | 3,228,050         | 4,136,826         | 4,724,770         |
| SIGAL Life UNIQA SH.A.F.P.*           | 576,615           | 961,625           | 1,442,152         | 788,946           |
| SIGAL UNIQA KS Jo-Jetë                | 8,368,689         | 9,222,743         | 10,912,741        | 12,390,804        |
| SIGAL Life UNIQA KS*                  | 5,000             | 188,126           | 238,858           | 338,738           |
| UNIQA MK Jo-Jetë                      | 7,538,356         | 8,041,964         | 10,371,295        | 10,216,259        |
| UNIQA Life MK*                        | 218,173           | 672,530           | 669,719           | 760,249           |
| GRUPI                                 | 37,485,397        | 39,913,167        | 46,692,100        | 51,195,794        |

\* SIGAL Life UNIQA SH.A.F.P ka filluar veprimtarinë më 30 Mars 2011. Të dhënat për Fondin janë progresive.

\* SIGAL Life UNIQA KS ka filluar veprimtarinë më Shtator 2011.

\* UNIQA Life MK ka filluar veprimtarinë më Maj 2011.

Prime të shkruara sipas produkteve për vitin 2014



| Lloji i Produktit           | AL<br>(në Euro)   | KS<br>(në Euro)   | MK<br>(në Euro)   | Grupi<br>(në Euro) |
|-----------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|--------------------|
| Pasuri                      | 7,534,585         | 2,253,700         | 2,354,995         | 12,143,280         |
| M. Motorike                 | 11,943,005        | 7,467,287         | 7,015,585         | 26,425,877         |
| Jetë, Shëndet dhe Aksidente | 7,028,672         | 3,008,555         | 1,605,928         | 11,643,155         |
| Pensione Vullnetare*        | 788,946           | -                 | -                 | 788,946            |
| Risigurime*                 | 194,535           | -                 | -                 | 194,535            |
| <b>TOTALI</b>               | <b>27,489,743</b> | <b>12,729,543</b> | <b>10,976,508</b> | <b>51,195,794</b>  |


\* Produktet e Pensioneve vullnetare dhe Risigurimet ofrohen vetëm në Shqipëri përkatësisht nga kompanitë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Risigurime dhe SIGAL Life UNIQA SH.A.F.P.

# TREGU I SIGURIMEVE NË RAJON

## Tregu shqiptar i sigurimeve jo-jetë


Tregu i sigurimeve të jo-jetës, në të cilin operojnë 10 kompani, u udhëhoq nga SIGAL UNIQA e cila zotëroi 28.85% të tregut.

SIGAL UNIQA renditet gjithashtu e para edhe për pagesën e dëmeve duke paguar 27.55 % të dëmeve.




## Tregu shqiptar i sigurimeve të jetës

Që prej disa vjetësh, në tregun shqiptar të sigurimeve të jetës operojnë 3 kompani sigurimi. Edhe për vitin 2014 tregu u udhëhoq nga SIGAL Life UNIQA me 60.46% e cila ka paguar 47.56% të dëmeve të ndodhura në treg.




## Tregu shqiptar i pensioneve private

Gjatë vitit 2014, në tregun e pensioneve operuan 3 fonde pensionesh private. Fondi i Pensioneve SIGAL udhëhoqi tregun si për vlerën e aseteve neto (53.65 %) ashtu edhe për numrin e kuotave.




## Tregu kosovar i sigurimeve

Në tregun kosovar operojnë 10 kompani sigurimi ndër të cilat SIGAL UNIQA Kosova renditet e para me 15.51% të tregut për volumin e primeve si dhe ka paguar 13.94% të dëmeve totale të tregut.




Në tregun kosovar të sigurimeve të jetës operojnë 3 kompani ndër të cilat SIGAL Life UNIQA Kosova renditet e treta me 13.83% të tregut për volumin e primeve dhe ka paguar 16.16 % të dëmeve.




## Tregu maqedonas i sigurimeve

Në tregun maqedonas të sigurimeve të jo-jetës operojnë 12 kompani. UNIQA a.d. u rendit në vendin e gjashta për nga volumi i primeve të shkruara (9.33%) dhe ka paguar 7.47 % të dëmeve.



UNIQA Life renditet e treta në tregun maqedonas të sigurimeve të jetës (5.26 %) në të cilin operojnë 5 kompani.



SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.  
Pasqyrat Financiare te Konsoliduara  
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014  
(me raportin e aUdituesit te pavarur bashkelidhur)

*Consolidated Financial Statements  
as at and for the year ended 31 December 2014  
(with the independent auditor's report thereon)*

# RAPORTI I PAVARUR I AUDITIT

## Për aksionarët dhe Bordin e Drejtorëve të SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.A.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur të SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.A. dhe filialeve të saj ("grupi") të cilat përbëhen nga pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2014 dhe pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, ndryshimet në kapital dhe flukset e parasë për vitin ushtrimor të mbyllur më këtë datë si dhe nga një përmbledhje të politikave të rendesishme të kontabilitetit dhe informacion tjetër shpjegues.

## Përgjegjësia e drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo gabimit.

## Përgjegjësia e audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare të konsoliduara bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që në të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara janë pa anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar e evidencën e auditimit rreth shumave dhe shënimeve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare të konsoliduara. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut të anomalive materiale të pasqyrave financiare të konsoliduara, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë kryerjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara me qëllim që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të njësisë ekonomike. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare të konsoliduara. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

## Opinion

